



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA DIMAL
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM
NR 10 DATË 28.02.2022

PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT TË PRONAVE NGA MINISTRIA E MBROJTJES NË FAVOR TË BASHKISË DIMAL “

Këshilli Bashkiak Dimal në mbledhjen e tij të datës 28.02.2022, bazuar në materialin e paraqitur nga Drejtoria Juridike ,në mbështetje dhe zbatim të Ligjit Nr.139/2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”, i ndryshuar, Neni 9 pika 1.2 Neni 53, 54 55, Ligji Nr 107/2014”Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit”, i ndryshuar, VKM Nr 408 datë 13.05.2015”Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, Ligji Nr 8744 datë 22.02.2002”Për transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore”, indryshuar, Shkresës së Ministrisë së Mbrojtjes Nr 4154 Prot datë 28.12.2021”Mbi caktimin e detyrimeve që duhet të plotësojnë bashkitë për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave nga Ministria e Mbrojtjes te bashkitë ,si dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Dimal

VENDOSI

Me 15 vota PRO nga 15 Këshilltarë prezentë në mbledhje të miratojë:

1. Këshilli i Bashkisë Dimal ti propozjë Ministrisë së Mbrojtjes Vendimin”Për fillimin e procedurave për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit të pronave nga Ministria e Mbrojtjes në favour të Bashkisë Dimal”, për pasurinë me Nr 280/3, sipërfaqe 12300 m², zonë kadastrale 3978, me emërtimin”Aviacioni”, pasuri që sot është përfshirë në pasurinë e madhe të aviacionit ,me kordinata:

A: X=490177.29 Y=4515799.06 B: X=490205.85 Y=4515846.1

C: X=490402.92 Y=4515616.76 D: X=490351.12 Y=4515726.8 dhe vendndodhje në territorin administrative të Bashkisë, për zhvillimin e tregut të përzier .

2.Për zbatimin e këtij Vendimi ngakrohet Kryetari i Bashkisë Dimal

3.Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij,sipas parashikimeve të nenit 55 pika 6 të Ligjit Nr 139/2015”Për Vetëqeverisjen Vendore”,i ndryshuar.

Kryetar i Këshillit Bashkiak
Hysen Hoxha

